



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-15923/20 datë:19.08.2020



Npi – 01/183 datë: 31.08.2020

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.01-070/05-14165/20 datë:05.08.2020, të z.Gani Ademaj nga fshati Petrovë, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes në emër të 67 banorëve (nënshkrimet) nga fshati Petrovë ka kërkuar, shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.xxxx; Evidentuar pronë e Hamide Ademaj nga fshati Petrovë, me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të banorëve dhe nxënësve si dhe shtrirjen e gypave të ujësjellësit dhe kanalizimit. (Kërkesa e pa kompletuar – Mungon Fleta Poseduese e ngatrës/ave kadastrale).

Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pikat (c dhe f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Pasi që diskutoi për kërkesën e palës, dhe Rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR HEDHJEN POSHTË TË KËRKESËS Nr.01-070/05-14165/20 TË GANI ADEMAJ
NGA FSHATI PETROVË**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 31.08.2020, unanimisht aprovoi vendimin për hedhjen poshtë të kërkesës me numër: Nr.01-070/05-14165/20, datë:16.06.2020, të z.Gani Ademaj nga fshati Petrovë. Me arsyetimin se kërkesa nuk është e kompletuar dhe nuk është adresuar nga pronari ose i autorizuari i pronës së paluajtshme.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj